



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 262/2023

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 11, 40, Rregulloren për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit 01/Nr.9274/2019, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 31. 01. 2023 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2023

1. Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për planin e punës së këshillave lokale në Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2023.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës së këshillave lokale në Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2023.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendimi njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorja e Administratës,
- Këshillat lokale të Komunës së Hanit të Elezit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 31. 01. 2023





01/ Nr./253/ 2023

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11 , 40, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal numër Nr.03/L-049 neni 2, dhe në bazë të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me numër 01/Nr.2821/ 2022 të datës 31.05.2022 neni 14, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2023 merr:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR BURSA PËR STUDENTËT E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për bursa për studentët në Komunën e Hanit të Elezit për vitin akademik 2022/2023.
2. Mjetet financiare të cilat do të dedikohen për ndarjen e bursave për studentë merren nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere vlera e të cilave është në shumë prej 20,000.00 €, që do të përfitojnë 40 (katërdhjetë) studentë për dhjetë muaj nga 50.00 € në muaj.
3. Prioritetet për kuadro deficitare janë në Fakultetet:

Fakulteti i Mjekësisë (Mjekësi e Përgjithshme, Stomatologji).

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (Konstruksioneve, Hidroteknikës, Gjeodezisë, Inxhinierisë së Ambientit, Arkitekturë dhe Eficiencë e Energjisë).

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (Inxhinieri Kompjuterike, Telekomunikacion, Elektronikë, Automatikë, Sistemet Elektroenergjetike, Elektroenergjetikë Industriale).

Fakulteti i Edukimit (Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji dhe TIK)

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (Prodhimtari dhe Automatizim, Termoenergjetikë dhe termoteknikë, Konstruksione dhe mekanizim, Komunikacion).

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë (Agroekonomi, Bioteknologji në Zooteknik, Lavërtari – Perimtari, Mbrojte e Bimëve, Pemëtari – Vreshtari, Veterinari, Bioteknologji Ushqimore).

Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë (Xehetarisë, Gjeologjisë, Materiale dhe Metalurgji, Teknologjisë).

Fakulteti i Shkencave Matematikë – Natyrore (Matematikë, Fizikë dhe Kimi),

Fakulteti Arteve

Fakulteti Filologjik (Gjuha Angleze, Gjuha Gjermane).

4. Bursat ndahen për studentët e vitit të dytë e lartë. Në rast të mos plotësimit të bursave nga viti i dytë e lartë, plotësohet sipas rregullores për ndarjen e bursave edhe për vitin e parë të studimeve.

Përzgjedhjen e kandidatëve do ta bëjë komisioni i formuar nga drejtoria për arsim, kulturë, rini dhe sport sipas rregullores për ndarje të subvencioneve.

5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 31.01.2023





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr. 254/2023

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 11, 12 shkronja (d), 40, Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012-MPB-032012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi neni 9 paragrafi 1.7, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2023 merr:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR
VITIN 2023

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2023.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2023 për komunën e Hanit të Elezit.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi,
- Ministria e Punëve të Brendshme,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 31.01.2023





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 265/2023

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 64, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2023 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT FINACIAR PËR VITIN 2022

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin financiar për vitin 2022.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i financiar për vitin 2022 i hartuar nga drejtoria për buxhet dhe financa.
3. Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë për vitin 2022 është në lartësi prej 2,759,758.00€, ndërsa ai përfundimtar është 2,997,869.29 €. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-dhjetor 2022 është në shumë prej 2,704,227.52 € apo 90.20%. Prej tyre për Paga dhe shtesa janë shpenzuar 1,694,967.79 € apo 95.11 %, mallra dhe shërbime 396,616.33 € apo 96.56 %, shpenzime komunale 67,684.20 € apo 99.98 %, subvencione dhe transfere 85,967 € apo 98,81 % dhe shpenzime kapitale 458,992.20 € apo 75.68 %.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 31.01.2023





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 115/2023

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 40.2, 68.3, Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna neni 6, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit me numër 01/Nr.7703/2018 neni 79, 80, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2023 merr:

VENDIM

**PËR DRAFT PLANIN KOMUNAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE PËR VITET
2023-2027 NË KOMUNË E HANIT TË ELEZIT**

1. Me këtë vendim aprohet Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027 në Komunën e Hanit të Elezit.
2. Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027 në Komunën e Hanit të Elezit lëshohet në procedurë të diskutimit publik me qytetarët.
3. Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë që t'i zhvilloj procedurat e diskutimit publik me qytetarët dhe ekzekutivin e komunës dhe pas kësaj rezultatet e diskutimit publik t'i paraqet në Kuvendin e Komunës për finalizimin e Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027 në Komunën e Hanit të Elezit.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është draft Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027 në Komunën e Hanit të Elezit.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 31.01.2023





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr. 266/2023

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Udhëzimin Administrativ Nr.01/2016 për Procedurat e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, neni 11 pika 3, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit neni 55, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2023 merr:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS PËR KATËR KOMITETET KONSULTATIVE
PËR VITIN 2023

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës për katër komitetet konsultative të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës për vitin 2023 për mbledhjet që do të mbahen për komitetin konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit, për komitetin konsultativ për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për komitetin konsultativ për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe komitetin konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Komitetet Konsultative
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 31. 01. 2023

